



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## DREJTORATI PËR ARSIM

Nr- 01-111/01-20592  
Datë: 05.05.2026

Bazuar në nenin 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 dhe 2.5 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të Drejtorëve dhe zv. Drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Përsoneleit të shërbimeve të përbashkëta në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, nenit 80 dhe 81, të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, nenit 5 (pikë c) të Ligjit mbi Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, nenit 35 (paragrafi 2 dhe 4) i Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Udhëzimit Administrativ 05/2021 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall:

### KONKURS

#### PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR PERIUDHË TË CAKTUAR TË ANGAZHIMIT

**Titulli i vendeve të punës: Mësimdhënës/e**

**Në disa SHFMU:**

- Zëvendësim: 20 orë mësimi në javë, Gjuhë Shqipe një (1) pozitë;
- Zëvendësim: 20 orë mësimi në javë, Gjeografi një (1) pozitë;
- Zëvendësim: 20 orë mësimi në javë, TIK dy (2) pozita;

Departamenti/Drejtoria: Drejtorati për Arsim

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i Pozitave: (04) katër

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Shkollës

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar

**Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publik**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; - Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligji.

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë për Mësimdhënës/e**

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me Udhëzimet Kurikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës, si dhe
- Detyrat tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

#### **Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit arsimor:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas UA Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional. Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre Udhëzimeve Administrative nuk do të shqyrtohen, përkatësisht refuzohen.

#### **Dokumentet e nevojshme:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Rezymeja Personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;
- Diplomat e kualifikimit ose certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara tek noteri.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (original);
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka duhet ta dorëzohet referencën nga pundhënësi);
- Nëse kandidati/ja ka interes të aplikoj në më shumë vende, atëherë duhet të bëjë aplikim të ri për secilën shkollë, duke i bashkangjitur të gjitha dokumentacionet e kërkuara;

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, do të jetë në varësi të lirimit real i vendit të punës (datës së pensionimit, pushimit të lehonisë apo mungesës tjetër).

**Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda pesë (05) ditëve nga data 06.05.2026 – 10.05.2026.**

**Paraqitja e kërkesave:** Kandidatët e interesuar, duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Komunën e Lipjanit.

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

- Njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/lipjan>, Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.

Xhevahire Zeqiri

Udhëheqëse për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

